



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 15 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit

Felisiti Geri

Xhejms O'Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullave 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 12 prill 2024, Mbrojtja e Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari” dhe “Mbrojtja”) dorëzuan kërkesë për zgjatjen e afatit të caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake² për përfundimin dhe dorëzimin e formularëve, përfshirë dokumentacionin mbështetës, të nevojshëm për t’i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative (“Kërkesa”).³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, në qoftë se i tregohen arsye të vlefshme ose *proprio motu*, Trupi Gjykues mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara në Rregullore apo prej Trupit Gjykues.

3. Në bazë të rregullës 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë për t’i lënë Trupit Gjykues kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik. KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake* (“Vendimi mbi Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake”), 27 mars 2024, publik, para. 30(a)-(b).

³ KSC-BC-2023-10, F00250, Mbrojtja, *Kërkesë e Bahtijarit për Zgjatje të Ndihmës Juridike*, 12 prill 2024, publik.

III. DISKUTIM

4. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të rregullës 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje afati duhet të paraqiten në kohë për t'i lënë Trupit Gjykues kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kërkesa është dorëzuar ditën e përfundimit të afatit përkatës, d.m.th të premten, më 12 prill 2024.⁴ Sidoqoftë, duke mbajtur parasysh rëndësinë e situatës me financimet për (i) të garantuar të drejtat e të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore dhe (ii) për të përgatitur sa më shpejt çështjen për të kaluar për gjykim,⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon të bëjë një përjashtim dhe ta shqyrtojë kërkesën. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson që Mbrojtja duhet të përpiqet në të ardhmen të dorëzojë kërkesat sipas rregullës 9(5) në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afatit përkatës.

5. Sa i përket arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se (i) thujse të gjithë dokumentet përkatëse për dorëzimin e kërkesës për ndihmë juridike janë dhënë nga familja e z. Bahtijari⁶ dhe (ii) dy dokumentet e mbetura janë plotësuar dhe/ose janë kërkuar, por Mbrojtësi i z. Bahtijari nuk i ka marrë ende.⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e afatit të kërkuar.

IV. VENDIM

6. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

⁴ Vendimi mbi Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake, para. 30(a)-(b).

⁵ *Shih* Vendimin mbi Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake, para. 14.

⁶ Kërkesa, para. 2.

⁷ Kërkesa, para. 3-4, 6.

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të plotësojë formularët e mbetur, bashkë me dokumentacionin mbështetës, për t'i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative, si dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake deri të premten, 19 prill 2024.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 15 prill 2024
Në Hagë, Holandë